




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Prishtinë, Dërrmësi Prishtine, District No.	25.01	2	MMI MMI
Prishtinë, Dërrmësi Prishtine, District No.	347/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A. Nr. 1197/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Zyle Gojnovci Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1197/2021 të datës 17.12.2021, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi

Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 25.01.2022, mori këtë;

V E N D I M

- I. Refuzohet ankesa me numër A.nr.1197/2021 e datës 17.12.2021 e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër reference 1264 i datës 12.11.2021 i Menaxheres së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me datë 17.12.2021, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6219/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër reference 1264 të datës 12.11.2021 të Menaxheres së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për shkak të: shkeljes esenciale së dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil, shkeljes esenciale të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, shkeljes së Ligjit Nr.03/L-147 për Paga të Nëpunësve Civil dhe shkeljes së Rregullores për Kompensimin e Pagave.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 23.12.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërsa, Këshilli më datë 31.12.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokolli 6447/2021, se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.1197/2021 e datës 17.12.2021 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Sqarimet shtesë dhe plotësim të dokumenteve lidhur me ankesën A.nr.1197/2021, Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të datës 28.12.2018, Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në Punë pa nënshkrim, Vendimin Nr.106/2021 të datës 08.09.2021 i Komisionit të Ankesave, Vendimin Nr.105/2021 të datës 08.09.2021 të Komisionit të Ankesave, Akt emërimit me ref.DRGJC/ARC-14/13 të datës 31.01.2013, Kontratën e Punës të datës 01.06.2004, Vërtetimin me numër protokolli 781/0819 të datës 20.08.2019 të lëshuar nga Kolegji AAB, Pasqyrë e Notave e datës 20.08.2019, Diplomën me numër 557/0715 të datës 21.07.2015, të dhëna mbi pagën e ankueses Vendimi me numër reference 1264 i datës 12.11.2021 të Menaxheres së Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Vendimin me numër protokolli 890 të datës 12.02.2019, i Drejtorit të Përgjithshëm i ARC-së; e-maili i datës 26.07.2017 nga M.S per ankuesen, email i datës 27.09.2027 nga ankuesja për F.A dhe Sh.H, email i datës 08.09.2017 E.A për ankuesen dhe etj, Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 6447/2021 të datës 31.12.2021, Listën e pagave me numër protokolli 469 të datës 19.12.2021, fq. ½, Vendimin me numër protokolli 2391 të datës 10.11.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pa bazuar sepse:*

Nga administrimi i prova të lëndës është konstatuar se ankuesja sipas Akt Emërimit me ref. DRGJC/ARC-14/13 të datës 31.01.2013, është emëruar në pozitën e punës Nëpunëse Administrative në Qendrën për Pajisje me Dokumente, në kuadër të Agjencisë për Regjistrim Civil (tutje ARC), pa afat, me koeficient gjashtë (6) të pagës.

Me Vendimin me numër protokolli 890 të datës 12.02.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të ARC-së, ankuesja nga pozita Nëpunëse Administrative në Qendrën për Pajisje me Dokumente, është caktuar përkohësisht në pozitën e punës Zyrtare e Lartë në Sektorin e Gjendjes Civile në Drejtoratin e Gjendjes Civile, me koeficient të njëjtë të pagës gjegjësisht gjashtë (6). Ndërsa me Vendimin me numër protokolli 2391 të datës 10.11.2021, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të ARC-së, ka shfuqizuar Vendimin me numër protokolli 890 të datës 12.02.2019, duke e kthyer ankuesen në pozitën e saj të punës Nëpunëse Administrative në Qendrën për Pajisje me Dokumente në Prishtinë.

Me datë 12.11.2021 Menaxherja e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me Vendimin nr.ref.1264/2021 ka transferuar përkohësisht ankuesen nga pozita e nëpunëses administrative në Drejtoratin për Pajisje të Dokumenteve në Prishtinë, në pozitën e punës Zyrtare e Gjendjes Civile në Sektorin e Gjendjes Civile në Drejtoratin e Gjendjes Civile, me kohëzgjatje nga data 15.11.2021 deri 14.05.2022, me koeficient shtatë(7).

Ankuesja brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër reference 1264 të datës 12.11.2021 të Menaxheres së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për shkak të: shkeljes esenciale së dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil, shkeljes esenciale të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, shkeljes së Ligjit Nr.03/L-147 për Paga të Nëpunësve Civil dhe shkeljes së Rregullores për Kompensimin e Pagave, me tej pretendon se me Vendimin me numër 890/2019 të datës 12.02.2019, ankuesja ishte degraduar sepse sipas këtij vendimi e njëjta ka ushtruar detyrat e punës së Zyrtares së Lartë me koeficient gjashtë (6) të pagës edhe pse për pozitën në fjalë koeficienti është tetë (8). Thekson se edhe me vendimin e kontestuar me numër reference 1264 të datës 12.11.2021 ankuesja serish është degraduar duke u caktuar vetëm si Zyrtare e Gjendjes Civile me koeficient shtatë të pagës edhe pse detyrat dhe përgjegjësitë janë të njëjta me pozitën e zyrtares së lart. Kërkon që Këshilli ta kthej Vendimin e datës 12.02.2019 si zyrtare e lartë, dhe ti njeh të drejtën e kompensimit të dallimit të pagës me të gjitha shumatat monetare të papaguara nga data e emërimit si Zyrtare e Lartë në Sektorin e Gjendjes Civile.

Lidhur me shqyrtimin perëndimeve ankimore të ankueses që ti behët kompensimi i dallimit të pagës për pozitën e punës Zyrtare e Lartë në Sektorin e Gjendjes Civile sipas Vendimit me numër protokoll 890 të datës 12.02.2019, Kolegji duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, i cili përcaktonte se: *"Nëpunësit civil kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës"*, konstatoi se ankesa lidhur me këtë pretendim ankimor është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili parasheh se: *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"*, respektivisht në rastin konkret vendimi në fjalë është nxjerrë me data 12.02.2019, ndërsa ankuesja parashtron ankesë me datë 17.12.2021, gjegjësisht pas një (1) viti.

Përkitazi me pretendimin ankimor që ankuesja është degraduar me Vendimin e kontestuar respektivisht Vendimin me numër reference 1264 të datës 12.11.2021 të Menaxheres së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme duke pretenduar që ti kthehet pozita e punës si Zyrtare e Lart sipas Vendimit me numër protokoll 890 të datës 12.02.2019, Kolegji bazuar në shkresat e lëndës, ka konstatuar se sipas Vendimit me numër protokoll 890 të datës 12.02.2019, ankuesja në mbështetje të nenit 30 të Ligjit Nr.04/L-149 për Shërbimin Civil ishte caktuar vetëm përkohësisht si ushtruese e detyrës së Zyrtares së Lartë në Drejtorarin e Gjendjes civile dhe rrjedhimisht pasi që ankuesja nuk kishte caktim/emërim të përhershëm në këtë pozitë rezultoi se nuk ka pasur ndonjë degradim të ankueses në raport me pozitën e saj dhe koeficientin e pagës sipas Akt Emërimit me ref. DRGJC/ARC-14/13 të datës 31.01.2013, kështu që pretendimi ankimor mbi këtë bazë nuk qëndron.

Andaj, bazuar në të gjeturat si me lart, dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nenparagrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A. Nr. 1197/2021

Zyle GOJNOVCI

Procesmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshme të ARC-së;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

